



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d dhe nenit 14, paragrafi 1 i Ligjit nr. 03/L – 040, për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/15, qershor 2008), nenit 11, paragrafit 4 i Ligjit nr. 04/L-144, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 35/17, dhjetor 2012), dhe të nenit 34, paragrafi 34.1 i Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të datës 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 18.05.2016, merr këtë

VENDIM

Neni 1

Miratohet propozimi i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronave të paluajtshme në pronësi të Komunës me pronat e paluajtshme të planifikuara për interes publik, në pronësi të:

1. Hakif Thaqit dhe
2. Nezir Mehmetajt

Neni 2

Me këtë vendim lejohet këmbimi i:

1. pronës së paluajtshme në pronësi të Komunës, pjesë e parcelës nr. 741 - 14, Certifikatat e pronësisë nr. P – 71914050 – 00741 – 14 , Zona kadastrale Matiçan, me
2. a. pronën e paluajtshme, në pronësi të Nezir Mehmetajt, përkatësisht parcelën nr. 714 – 12, Certifikata e pronësisë nr. P – 71914050 – 00741 – 12, Zona kadastrale Matiçan dhe
b. pronën e paluajtshme, në pronësi të Hakif Thaqit, përkatësisht parcelën nr. 714 – 13, Certifikata e pronësisë nr. P – 71914050 – 00741 – 13.

Neni 3

Para shpalljes publike të vendimit, Komuna do të sigurojë vlerësimin e kualifikuar e të pavarur të vlerës së tregut të secilës pronë komunale dhe pronës në pronësi të personave fizikë.

Neni 4

Këmbimi i cekur në pikën II të këtij vendimi, do të publikohet në ueb-faqen e Komunës dhe tabelën e shpalljeve, me të dhënat e pronave të këmbyera, vlerën e tyre, si dhe emrin e pronarit me të cilin është bërë këmbimi.

Neni 5

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtorja e Financave dhe Pronës dhe Drejtorja e Kadastrit.

Neni 6

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01. nr. 035-121629 , më 19.05.2016



KRYESUESI I KUVENDIT
Halim Halimi / jur. i dipl.